



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 6066/2023

Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, bëjë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e shtatë -VII- të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 31.07.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2023.
3. Plotësim-ndryshim i vendimit me numër 01/Nr. 5011/2023 për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2020, 2021 dhe 2022 në vitin 2023".
4. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2023 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.
5. Njoftim për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2023.
6. Informatë për sektorin e emergjencave.
7. Të ndryshme.

Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-

- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e raportit financiar për periudhën Janar – Qershor 2023.
- Materialin e plotësim-ndryshim i vendimit me numër 01/Nr. 5011/2023 për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2020, 2021 dhe 2022 në vitin 2023".
- Materialin e raportit financiar për periudhën Janar – Qershor 2023 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.
- Materialin e njoftimit për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2023.
- Materialin e informatës për sektorin e emergjencave.

Hani i Elezit
Data:-21.07.2023





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 6067/2023
Data: 21.07.2023

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e gjashtë -VI- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 29.06.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtorja për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026.
3. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hani të Elezit për vitin 2022.
4. Plani i Veprimit të Komunës për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hani të Elezit për vitin 2022.
5. Kërkesa për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale.
6. Plotësim-ndryshim të vendimit Nr.01/1116 kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga 2022 në vitin 2023.
7. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.
8. Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Hani të Elezit 2023 – 2025.
9. Draft Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 të Komunës së Hani të Elezit.
10. Draft plani i veprimit për Transparencë 2023-2026 i Komunës së Hani të Elezit.
11. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për rendin të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- korniza afat mesme është hartuar në bazë të qarkores buxhetore që është dërguar nga Ministria e Financave. Planifikimi i buxhetit për vitin 2024 është në shumë prej 3,349,278.00 €, planifikimi i buxhetit për vitin 2025 është në shumë prej 3,521,381.29€, planifikimi i buxhetit për vitin 2026 është në shumë prej 3,693,420.00 €. Është mbajtur dëgjimi buxhetorë për Korniza Afatmesme Buxhetore Nëse keni ndonjë vërejtje dhe sugjerim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- të hyrat vetanake grumbullohen nga tatimi në pronë dhe taksat e ndryshme komunale. Për vitin 2024 komuna jonë ka paraparë një rënie të të hyrave vetanake në shumë prej 285 745 00 € apo 51%. Si e ka paraparë komuna që të jetë kjo rënie e të hyrave vatanake. Si qytetarë duam të dimë se a do të kemi falje të tatimit në pronë dhe tokë sepse kjo ulje e prekë drejtë për drejtë qytetarin apo ndoshta keni planifikuar ndonjë ulje të taksave në biznes që ju ndoshta keni leverdi apo ndoshta bashkëpunoni me ta. Te plani i shpenzimeve për vitin 2024 na bërë përshtypje një vlerë prej 17 % të buxhetit të ndarë për investime kapitale dhe kjo përqindje kapë vlerën prej 500 000 € e që është 400 000 € më pak dhe vërehet që ekzekutivi i komunës nuk ka një pasqyrë planesh se si do implementojë dhe këtë na i vërtetojë tabelari i paraqitur nga komuna i cili përveç përshkrimit të projektit nuk pamë që është paraqitur diçka tjetër por ishte boshë dhe kur është bosh tregon përkushtimin dhe angazhimin e disa ekspertëve, e krejt çka ishte me qesharake ishte pjesa e dytë që komuna i kishte të renditura objektivat dhe prioritete e saja për vitin 2024-2026. Në këtë kornizë për vitin 2024-2026 kishte prioritet zgjidhjen e problemit të mungesës së ujit e cila sot është dashur të përfundon. Përveç kësaj ishte edhe rregullimi i terreneve sportive nëpër fshatra por në komunën tonë secila shkollë gëzon terene sportive, kabinete dhe secili mësimdhënës i ka kushtet e mira për mësimdhënie. Një prioritet tjetër ishte dhe hapja e qendrave sportive nëpër fshatra dhe nëpër media po flisni për ikjen e të rinjve nga komuna jonë të cilën e potenconi pa ju bërë fare përshtypje ndërsa në anën tjetër po i orientoni politikat e juaja në investime për të rinjtë por mirë do të bëni që prioritet e juaja t'i adresoni tek moshat e shtyra që të ju siguron ekupe mjekësore njëzet e katër orë, të ndërtoni qendër ditore për pensionistë. Është paraparë renovimi i QKMF-së ndërsa për investim ishin paraprir vetëm 5000 €. Në material shënon për vizita shtëpiake por nuk pash planifikim për rritje të stafit në QKMF. Ishte paraparë funksionalizimi i AMF-së në fshatin Gorancë të cilën ne po e quajm qendër të mjekësisë familjare. Ju keni potencuar që AMF-ja është funksionalizuar në vitin e kaluar por në objektiva është dashur ta keni furnizimin me medikamente dhe shtimin e kapaciteteve të shërbimeve, shtimin e stafit për njëzet e katër orë.

Lindita Ballazhi thekson:- sa i përket uljes së të hyrave vetanake ka qenë kërkesa e jonë për ulje të të hyrave vetanake pasi që gjatë vitit 2022 planifikimi i të hyrave vetanake ka qenë në vlerë prej 381347 € dhe nuk kemi arritur që t'i inkasojmë këta të hyra dhe kemi inkasuar vetëm 88 % nga të hyrat e planifikuara dhe për këtë arsye kemi bërë vazhdimisht kërkesa në Ministri për zvogëlimin e këtyre të hyrave dhe kërkesat tona janë aprovuar. Sa i përket faljes së tatimit në pronë dhe në tokë nuk kemi pranuar ende ndonjë vendim nga niveli qendrorë. Në plan të buxhetit ju e potencuat çështjen e investimeve kapitale por pjesa më e madhe është dedikuar në paga për shkak të ligjit të ri të pagave. Tabela e projekteve është dorëzuar në atë formë në Komitet për Politikë dhe Financa dhe e potencova edhe arsyetimin, ndërsa në kuvend është e plotësuar. Në kornizën afat mesme buxhetore janë të përfshira të gjitha objektivat e qeverisjes sonë që janë të listuara 78 objektiva që prej tyre e kemi edhe përqindjen e këtyre objektiveve se sa i kemi arritur.

Sevdi Dernjani thekson:- përveç objektivave në kornizën buxhetore janë mbajtur edhe dëgjime buxhetore për të cilën qytetarët kanë propozuar projekte dhe në dëgjime buxhetore nuk kanë marr pjesë asnjë subjekt politikë . Çështjen e ujit e kemi diskutuar por mundem me potencuar që jemi në fazën finale që është bërë pranim dorëzimi i të gjitha pajisjeve të sistemit të ujit në fshatin Dimcë, i ka kaluar kompanisë Bifurkacioni dhe aj ujë që është ajo do të vjen sepse është një investim që ka kushtuar një milion euro dhe nuk mundemi me gjuajt poshtë por jemi tu dashur me finalizuar këtë projekt dhe pastaj me i shikuar mundësitë e tjera si janë . Ikja e të rinjve si fenomen është në tërë Kosovën por edhe në rajon për perspektiva të ndryshme por sa i përket intervenimit si ekzekutiv se çka jemi tu bërë unë mundem me t'i përmendur projektet se çka jemi duke bërë është ndarë një zyre për të rinjtë , me bankën botërore e kemi financuar projektin për të rinjtë, e kemi ndarë zyrën për pensionistët , është realizuar parku i qytetit, janë duke u realizuar parqet e tjera që besojë që janë projekte për këtë moshë që u përmend që do të thotë janë projekte që moshat e shtyra i prekin direkt. Nga fillimi që ka filluar AMF-ja është në standardin siç ka qenë është funksionale.

Refet Kalisi thekson:- përcaktimi i vlerës së granteve a është gabim teknik për shkak se është e paqartë. Te garanti specifik për arsim mallra dhe shërbime në shumë prej trembëdhjetë milionë e dyqind mijë euro që mu dukë një shumë e pa kapshme , shpenzimet kapitale në shumë prej dy milionë e treqind mijë . Financimi i investimeve kapitale për vitin 2025-2026, është paraparë ndriçimi publik nëpër fshatra që unë mendoj se ndriçimin publik e kemi nëpër të gjitha fshatrat dhe duhet të potencohet me ndonjë fshat që nuk ka ndriçim publik . E njëjta gjë është shënuar edhe të riparimi i rrugëve . Shtimi i kapaciteteve të ujit në Lagje duhet ti jepet më shumë rëndësi për shkak se kemi probleme me ujë . Është dashur të ceket se në cilat fshatra do të shtrohen rrugët për shkak se edhe në ish qeverisje i kemi shënuar kështu dhe kemi pasur kritika.

Lindita Ballazhi thekson:- tabelat janë shkëputur nga qarkorja buxhetore e cila na është dërguar nga Ministria e Financave dhe numrat që jeni duke i shikuar janë në vlerave të milionave.

Arsim Dernjani thekson:- çështjen e ndriçimit publik duhet me përfshirë në të gjitha fshatrat për shkak se shtrohen rrugët me asfalt apo me kupëza beton dhe kërkohet të bëhet ndriçimi publik.

Refet Kalisi thekson:-me një shumë prej 10000 € gjitha fshatrat nuk ndriçohen dhe nëse shtrohet ndonjë rrugë me një fshatë e cekë rrugën dhe vlerën.

Sevdi Dernjani thekson:- bëhet një kontratë që është e përgjithshme për tërë qytetin dhe fshatrat që nënkuptohet që me ndonjë projekt të caktuar me ndonjë fshat mundet me kushtuar vlera prej 1000 € dhe pastaj mund të dalin edhe kërkesa tjera për të cilat e kemi të zhvilluar procedurën.

Hatmije Kalisi thekson:- te financimi i investimeve kapitale është shënuar dy herë ndërtimi i mureve mbrojtëse në lagje të re dhe në fshatrat Paldenicë, Dermjak, Pusteni pra është e njëjta tabelë dy herë me shifra të ndryshme.

Lindita Ballazhi thekson:- është një gabim teknik dhe do të përmirësohet.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 11 për , 2 abstenim.

3. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022 është opinion i pa modifikuar , opinione pozitive me pesë të gjetura. Materialin e keni në detaje dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- me njërën prej mbledhjeve të kuvendit kur është prezantuar raporti financiarë për vitin 2022 i keni prezantuar disa shifra të shpenzimeve dhe në mbledhje të KPF-së më akuzuat me diçka të pa vërtetë për shkak se kur është hartuar raporti del që lëvizja vetëvendosje ka pasur të drejtë sepse raporti i auditori ka potencuar që është shpenzuar 71 % e buxhetit të investimeve kapitale , ndërsa drejtoria ka potencuar që janë shpenzuar 75.61 % e shpenzimeve kapitale .

Lindita Ballazhi thekson:- në raport është 75.6% për shkak se në fillim të muajit dhjetorë kemi pranuar një donacion nga Qeveria Japoneze dhe ky donacion është regjistruar në kuadër të kategorisë së investimeve kapitale gjë që e ka zhvendosur pak përqindjen . Raportet janë të gjeneruar prej sistemeve e jo të shpikura nga unë .

Sherif Berisha thekson:- unë po i referohem raportit të auditorit që na u ka përcjell në material bëhet fjalë për shumën prej 81000 € e cila nuk dihet se ku është dedikuar. Ju i keni paraqitur për vitin 2022 katër lloje të raportit të shpenzimeve buxhetore.

Lindita Ballazhi thekson:- këto që po i potenconi për katër lloje të raportit të shpenzimeve buxhetore nuk janë të vërteta dhe angazhoni ekspertët e juve financiarë që tu a sqarojnë më mirë.

Hyrijete Isufi thekson:- urdhër blerjet me vonesë nga një deri në tetëdhjetë e katër ditë për paga më të larta dhe për paga nën njëmijë euro njëmbëdhjetë deri në gjashtëdhjetë ditë. Kur janë ndarë mjetet financiare për shoqërinë kulturore artistike formularët për subvencion kanë qenë jo në rregull. Pse janë bërë këto vonesa.

Lindita Ballazhi thekson:- te subvencionet formularët nuk janë plotësuar siç duhet. Sa i përket vonesave në urdhërblerja kanë qenë për shkak të vonesës së faturave dhe zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjeve pas pranimit të faturave . Urdhërblerjet janë nxjerr me vonesë për shkak se është dashur të shikohet vlera e punimeve të projektit në mënyrë që me nxjerr urdhër blerjen.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4. Plani i Veprimit të Komunës për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- kjo ka të bëjë me planin se si do zbatohen rekomandimet e dhënë nga auditori . Në material janë të shënuara drejtorit përgjegjëse për zbatimin e këtij plani. Përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Resul Suma thekson:- vitin e kaluar ishin nëntë rekomandime, ndërsa tash janë katër rekoamdime që do të thotë që katër janë hequr dhe të përgëzoj për punën drejtoreshë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

5. Kërkesa për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- në material i keni shënimet në mënyrë të detajuar, nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- nga materiali të cilin e kemi pranuar shihet se nuk keni planifikuar mirë. Mjetet financiare të cilat i keni paraqitur në listën e investimeve unë mendoj se i keni paraqitur vetëm sa për sy e faqe për shkak se projektet ashtu siç po shihen janë keq planifikuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 11 për , 3 abstenim.

U MIRTUA KËRKESA PËR RELOKIM TË MJETEVE FINANCIARE NË KATEGORINË E SHPENZIMEVE KAPITALE

6. Plotësim-ndryshimi i vendimit nr 01/Nr.1116/2023 kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- kjo pikë e rendit të punës është miratuar në mbledhjen e kaluar por kemi pasur një kërkesë nga Ministria dhe për atë e kemi procedurë për kuvend.

Sherif Berisha thekson:- kërkoj sqarim për shumën e mjeteve financiare për te parku “Isa Berisha” në shumë prej 21000 € , shtrimi me kupëza betoni në Han të Elezit duke i përfshirë edhe tetë fshatra që ka një shumë prej 9000 € . Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatra në vlerë prej 24000 € . Shuma prej 9000 € për vendosjen e orëve në Han të Elezit dhe Lagje të Re.

Nexhmedin Daci thekson:- shuma e mjeteve financiare 21000 € është për shkak se kompania nuk i ka kryer punimet në vitin e kaluar dhe nuk kemi mundur me ja kryer pagesën dhe për atë janë bartura në këtë vit . E njëjta vlen edhe për rrugën në Pustenic që ende nuk e ka kryer projektin dhe mjetet financiare janë bartur për këtë vit. Mjetet financiare për shtrimin e rrugëve me kupëza betoni që kanë mbetur pa u shpenzuar i kemi dedikuar për shtrim të rrugicave për shkak se ka kërkesa për me u shtruar me kupëza betoni.

Refet Kalisi thekson:- te rruga “Isa Berisha” a kanë qenë të kontraktuara me të njëjtën kompani që nuk janë shpenzuar ato mjete apo tash keni me kontraktuar.

Nexhmedin Daci thekson:- për te parku Isa Berisha kompania nuk i ka kryer punimet vitin e kaluar dhe shuma e zotuar në vlerë prej 25 000 kanë mbetur pa u shpenzuar dhe duhet të barten.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLOTËSIM NDRYSHIMI I VENDIMIT NR 01/Nr .1116/2023 KËRKESË PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETNAKE TË PA SHPENZUARA NGA VITI 2022 NË VITIN 2023

7. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- propozoj që për anëtarë të komisionit të jenë Anëtarët e Komitetit për Politikë e Financa. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2024

8. Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Hanit të Elezit 2023 – 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- është plan që është hartuar nga komuna e Hanit të Elezit në bashkëpunim me Uendipinë dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme na është kërkuar që ta miratojmë këtë plan.

Ajnure Thaçi thekson:- gjatë vitit 2023 a kemi pasur ndonjë person të riatdhesuar.

Zaim Bela thekson:- a dihet numri i personave të cilët janë kthyer.

Natyra Kalisi thekson:- sa i përket statistikave nuk kam informacion.

Hyrijete Isufi thekson:- a keni pasur persona të tjerë të cilët nuk kanë jetuar këtu por kanë ardhur tash.

Natyra Kalisi thekson:- integrimi i të huajve ka të bëjë me personat të cilët e humbin shtetësinë për shkak se ka qytetarë që ju kërkohet që ta humbin shtetësinë Kosovare sepse i kërkon shteti i Gjermanisë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PLANI KOMUNAL PËR RIINTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATËDHESUAR DHE INTEGRIMIN E TË HUAJVE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT 2023-2025

9. Draft Strategjia për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje Qytetare 2023-2026 të Komunës së Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- Draft Strategjia është shqyrtuar në Komitet për Politikë e Financa dhe në Kuvendin e Komunës dhe është përcjell për në debat publik . Debat i publik është mbajtur.

Refet Kalisi thekson:- a keni menduar për transmetimin e seancave përmes ekranit televiziv.

Natyra Kalisi thekson:- sa i përket transmetimit të seancave përmes televizionit është një kosto e madhe , ndërsa për në jutube jemi t'i transmetuar.

Sherif Berisha thekson:-keni blerë pajisje moderne dhe është mirë që ta zbatoni vendimin e kuvendit.

Natyra Kalisi thekson:- është fakt që kemi investuar në pajisje por problem kemi me çështje të rrjetit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA DRAFT STRATEGJIA PËR INFORMIM KOMUNIKIM DHE PJESMARRJE QYTETARE 2023-2026

8. Draft plani i veprimit për Transparencë 2023-2026 i Komunës së Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- plani për transparencë i ka kaluar te gjitha procedurat . Përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Berisha thekson:- te drejtoria për buxhet dhe financa kërkoj të ketë llogari dhënie dhe transparencë.

Lindita Ballazhi thekson:- në drejtorinë për buxhet dhe financa gjithçka është e publikuar në veb faqe.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA DRAFT PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË 2023-2026 I KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- po diskutohet se është lëshuar një pëlqim për djegëje të gomave në kompaninë “Sharrcem”. A është e dëmshme djegëja e gomave.

Nexhmedin Daci thekson:- ju ka dhënë një pëlqim në parim për shqyrtimin e mundësive të përdorimit të lëndëve djegëse alternative e për të cilën ekzistojnë katalogje shtetërore se cilat lëndë mundën me u përdorë . Lëndët alternative përdorën në gjithë Evropën dhe janë lëndë të përpunuara por në vendin tonë nuk ka . Lejen për përdorimin e këtyre lëndëve e jep Ministria e Planifikimit Hapësinorë me kusht nëse ajo i plotëson standardet dhe kushtet të cilat kërkojnë me Ligj. Nuk ka lëndë djegëse të pa dëmshme për shëndet por ka pajisje të cilat e zvogëlojnë misionin e këtyre materieve të cilat lirohen gjatë djegëjes.

Sherif Berisha thekson:- stomatologut nga muaji Maj i ka skaduar kontrata dhe pse lejohet të punojë. A do ti vazhdohet kontrata që i ka skaduar stomatologut. A jeni në dioni për zëvendësimin e mjekut të cilin e keni kontraktuar nga Karitas Kosova që shpesh herë zëvendësohet me një mjek që nuk ka kontratë në punë . Për çfarë arsye është marr gjobë nga Inspektorati në shumë prej 1000 € . Kërkoj që të na sillen me shkrim të gjitha faturat e shpenzimeve që janë bërë gjatë javës kulturore për të cilat shpenzime siç kemi informacione ende nuk janë mbyllur. A do të ndërmerrni diçka për çështjen e qenve endacak.

Sevdi Dernjani thekson:- pyetjet për QKMF-në do të ja adresoj drejtoreshës edhe do të përgjigjet me shkrim pasi që nuk kam informacione. Çështja e qenve endacak është fenomen në tërë Kosovën e jo vetëm te ne por e kemi diskutuar edhe në KKSB por edhe me të gjithë kryetarët e komunave të cilët e kanë të njëjtën problematikë dhe pa na dërguar ndonjë vendim apo strategji qeveria ne nuk mundemi me vepruar.

Erbilin Meliqi thekson:- deshta me përgëzuar ekzekutivin për caktimin e pikës te komuna për grumbullimin e mbetjeve të kurbanave dhe mendoj që e ka larguar ndotjen e ambientit

Sherif Berisha thekson:-kjo është për me u përgëzuar por nëpër fshatra nuk e kanë cekur.


Arsim Dernjani thekson:- informimi ka qenë për të gjithë qytetarëve por është problem çështja e vetëdijesimit të qytetarëve.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:16.

Procesmbajtësi
Arifi Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Komuna – Municipality

Hani i Elezit



04/ 5638 /2023

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2023

Hani i Elezit, 2023

Përmbajtja

1	Hyrje	2
1.1	Performanca e të hyrave	2
1.2	Performanca e shpenzimeve	3
2	Buxheti komunal 2023.....	4
3	Krahasimi i pagesave për periudhën janar-qershor 2023/2022	5
4	Buxheti i Komunës sipas drejtorive dhe kategorive ekonomike.....	6
4.1	Pagat dhe shtesat për periudhën janar-qershor 2023	9
4.2	Mallrat dhe shërbimet për periudhën janar-qershor 2023	10
4.3	Shërbimet komunale për periudhën janar-qershor 2023.....	11
4.4	Subvencionet dhe transferet për periudhën janar-qershor 2023.....	11
4.5	Shpenzimet kapitale për periudhën janar-qershor 2023.....	12
5	Raporti i të hyrave vetanake për periudhën janar-qershor 2023.....	13

1. Hyrje

Raporti financiar për periudhën janar - qershor 2023, është përgatitur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4, si dhe Statutin e Komunës së Hanit të Elezit të nenit 51, paragrafi 5.

Ky raport përmban një përmbledhje të trendeve kryesore të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore përgjatë periudhës gjashtë mujore të vitit 2023. Raporti përmban analiza përmbledhëse të periudhës përkatëse, pasqyron të hyrat sipas drejtorive, sipas llojit të të hyrave si dhe krahasimet me periudhat paraprake dhe projeksionet buxhetore.

1.1 Performanca e të hyrave

Të hyrat vetanake: gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2023 kemi realizuar të hyra në shumë prej 165,032.38 € dhe paraqesin 29.4% të të hyrave të përgjithshme të planifikuara vjetore, ndërsa krahasuar me realizimin e gjashtë mujorit të vitit paraprak në vlerë prej 157,791.86 € kemi një rritje për 7,240.52 € ose 4.5%.

1.2 Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore: gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2023 pagesat ishin në shumë prej 1,261,122.61 € dhe paraqesin 37.64% të shpenzimeve të përgjithshme të planifikuara, ndërsa krahasuar me realizimin e gjashtë mujorit të vitit paraprak 2022 kemi një rritje të shpenzimeve prej 209,959.84€ apo 19.97 % më shumë shpenzime.

- **Shpenzimet për paga dhe shtesa** shënuan vlerën prej 960,996.65 € gjatë këtij gjashtë mujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 56.43% krahasuar me vlerën totale të buxhetuar për këtë kategori. Shpenzimet për paga dhe shtesa gjatë periudhës raportuese paraqesin një rritje prej 13.64% apo për 115,360.17 € më shumë krahasuar me shpenzimet e pagave dhe shtesave për periudhën e njëjtë të vitit 2022.
- **Shpenzimet për mallra dhe shërbime** shënuan vlerën prej 177,869.89 € gjatë këtij gjashtë mujori, duke arritur kështu normën e ekzekutimit 38.25%, krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një rritje në shpenzime për mallra dhe shërbime në krahasim me vitin paraprak me diferencë në shpenzim prej 80,114.07 €.
- **Shërbimet komunale** shënuan vlerën prej 35,558.54 € duke arritur kështu normën e ekzekutimit 36.84% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi një rritje të shpenzimeve për shërbime komunale në krahasim me vitin paraprak në vlerë prej 6,320.26 €.
- **Shpenzimet për subvencione dhe transfere** – gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2023 kemi pasur shpenzime të kësaj kategorie në vlerë prej 57,258.08 € ose 57.25% nga

planifikimi i të njejtës kategori, ndërsa përgjatë periudhës së njejtë të vitit 2022 shpenzimi për këtë kategori ka qenë në shumë prej 28,532.00 € apo 28,726.08 € më pak në krahasim me vitin aktual.

- **Shpenzimet kapitale** – Gjatë periudhës gjashtë mujore të vitit aktual shpenzimi për këtë kategori është në vlerë prej 29,439.15 € ose 2.98% nga shpenzimet e planifikuara për këtë kategori. Vitin e kaluar 2022, gjatë periudhës së njejtë raportuese shpenzimi për këtë kategori ka qenë në shumë prej 49,999.89 € apo 41.12% më shumë.

2. BUXHETI KOMUNAL 2023

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2023 është në lartësi prej **3,349,715 Euro**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa..... 1,702,823.00 €,
- Mallra dhe shërbime..... 465,000.00 €,
- Shërbime komunale..... 96,500.00 €,
- Subvencione dhe transfere.... 100,000.00 €,
- Shpenzime kapitale..... 985,392.00 €,
- Totali i buxhetit..... 3,349,715.00 €.

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-qershor 2023 është në shumë prej 1,261,122.61 € apo 37.64%.

Prej tyre shpenzimi sipas kategorive është si vijon:

- Paga dhe shtesa në shumë prej 960,996.95 € apo 56.43%,
- Mallra dhe shërbime në shumë prej 177,869.89 € apo 38.25%,
- Shërbime komunale në shumë prej 35,558.54 € apo 36.85%,
- Subvencione dhe transfere në shumë prej 57,258.08 € apo 57.25% dhe
- Shpenzime kapitale në shumë prej 29,439.15 € apo 2.99%.

3. KRAHASIMI I PAGESAVE PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2023/2022

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Buxheti 2023	Realizimi janar-qershor 2023	%	Buxheti 2022	Realizimi janar-qershor 2022	%	Krahasimi në euro 2023/22	Krahasimi në % 2023/22
Paga dhe shtesa	1,702,823.00	960,996.95	56.44%	1,756,083.00	845,636.78	48.15%	115,360.17	13.64
Mallra dhe shërbime	465,000.00	177,869.89	38.25%	385,975.00	97,755.82	25.32%	80,114.07	81.95
Shpenzime komunale	96,500.00	35,558.54	36.85%	67,700.00	29,238.28	43.19%	6,320.26	21.62
Subvencione dhe trans.	100,000.00	57,258.08	57.26%	80,000.00	28,532.00	35.67%	28,726.08	100.68
Shpenzime kapitale	985,392.00	29,439.15	2.99%	455,000.00	49,999.89	10.99%	-20,560.74	(41.12)
Rezervat	0	0	-	15,000.00	-	0.00%	0.00	-
TOTAL	3,349,715.00	1,261,122.61	37.65%	2,759,758.00	1,051,162.77	38.06%	209,959.84	19.97

Komente dhe shpjegime:

- Pagesat nga kategoria ekonomike **paga dhe shtesa** janë shpenzuar në shumë prej 960,996.95 € ose 56.44% të planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 pagesat për këtë kategori kanë shënuar rritje për 115,360.17 € ose 13.64%.
- Pagesat për këtë kategori ekonomike **mallra dhe shërbime** për gjashtë mujorin e parë të 2023 janë 177,869.89 € apo 38.25% e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 kemi rritje prej 80,114.07 € apo 81.95%.
- Pagesat për **shërbime komunale** për gjashtë mujorin e parë 2023 janë në shumë prej 35,558.54 € apo 36.85 % e planit vjetor, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 kemi një rritje prej 6,320.26 € apo 21.62%.
- Pagesat nga kategoria **subvencione dhe transfere** gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2023 kemi pasur shpenzime të kësaj kategorie në vlerë prej 57,258.08 € ose 57.25% nga planifikimi i të njëjtës kategori, ndërsa përgjatë periudhës së njëjtë të vitit 2022 shpenzimi për këtë kategori ka arritur shumën prej 28,532 €.
- **Shpenzimet kapitale** gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit aktual për këtë kategori janë në vlerë prej 29,439.15 € ose 2.99% nga shpenzimet e planifikuara për këtë kategori. Vitin e kaluar 2022, gjatë periudhës së njëjtë raportuese shpenzimi ka qenë në vlerë prej 49,999.89 € ose 41.12% më i lartë.

Gjithsej **shpenzimet për periudhën janar-qershor 2023**, për të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve janë në shumë prej 1,261,122.61 € apo 37.65% e planit të përgjithshëm vjetor, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një rritje prej 209,959.84 € apo 19.97 % më shumë shpenzime.

4. BUXHETI I KOMUNËS SIPAS DREJTORIVE DHE KATEGORIVE EKONOMIKE

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paalokuar	Aktuali	Zotim /Obligimet në pritje	Buxheti FreeBalance	Perqindja
CAT / RESP / PCLASS / SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	E
10 BUXHETI	2,791,483.65	2,166,945.72	624,537.93	1,167,687.52	118,916.42	1,473,232.87	41.83
659 HANI I ELEZIT	2,791,483.65	2,166,945.72	624,537.93	1,167,687.52	118,916.42	1,473,232.87	41.83
16035 ZYRA E KRYETARIT - HANI I ELEZIT	103,011.99	75,876.31	27,135.68	56,723.55	1,082.80	43,205.64	55.06
11 PAGA DHE SHTESA	78,011.99	50,876.31	27,135.68	44,477.88	0.00	33,534.11	57.01
13 MALLRA DHE SHËRBIME	25,000.00	25,000.00	0.00	12,245.67	1,082.80	9,671.53	48.98
16335 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	218,130.00	180,218.06	37,911.94	98,932.71	14,500.72	96,705.78	45.35
11 PAGA DHE SHTESA	93,130.00	55,218.06	37,911.94	47,606.57	0.00	45,523.43	51.12
13 MALLRA DHE SHËRBIME	65,000.00	65,000.00	0.00	27,474.07	6,746.91	22,788.23	42.27
14 SHPENZIME KOMUNALE	60,000.00	60,000.00	0.00	23,852.07	7,753.81	28,394.12	39.75
16935 ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL - HANI I ELEZIT	76,719.00	76,719.00	0.00	62,208.85	4,000.00	10,510.15	81.09
11 PAGA DHE SHTESA	61,719.00	61,719.00	0.00	59,872.27	0.00	1,846.73	97.01
13 MALLRA DHE SHËRBIME	15,000.00	15,000.00	0.00	2,336.58	4,000.00	8,663.42	15.58
17535 BUXHETI - HANI ELEZIT	59,600.99	36,454.94	23,146.05	31,823.57	1,638.24	26,139.18	53.39
11 PAGA DHE SHTESA	54,600.99	31,454.94	23,146.05	28,469.77	0.00	26,131.22	52.14
13 MALLRA DHE SHËRBIME	5,000.00	5,000.00	0.00	3,353.80	1,638.24	7.96	67.08
18444 PARANDALIMI DHE INSPEKTIMI I ZJARRIT	176,389.00	149,101.05	27,287.95	66,694.29	31,204.36	62,099.35	37.81
11 PAGA DHE SHTESA	66,389.00	39,101.05	27,287.95	34,266.29	0.00	32,122.71	51.61
13 MALLRA DHE SHËRBIME	60,000.00	60,000.00	0.00	32,428.00	5,153.61	19,846.39	54.05
30 PASURITË JOFINANCIARE	50,000.00	50,000.00	0.00		26,050.75	10,130.25	0.00
19675 ZYRA LOKALE E KOMUNITETEVE - HANI I ELEZIT	6,826.99	4,472.11	2,354.88	3,385.75	500.00	2,941.24	49.59
11 PAGA DHE SHTESA	6,326.99	3,972.11	2,354.88	3,385.75	0.00	2,941.24	53.51
13 MALLRA DHE SHËRBIME	500.00	500.00	0.00	0.00	500.00	0.00	0.00
47115 PYLLTARIA INSPEKSIONI - HANI I ELEZIT	32,438.00	21,544.67	10,893.33	16,347.35	525.06	15,550.59	50.40
11 PAGA DHE SHTESA	28,938.00	18,044.67	10,893.33	15,817.41	0.00	13,120.59	54.66
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,500.00	3,500.00	0.00	529.94	525.06	2,430.00	15.14
48035 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - HANI ELEZIT	24,544.00	17,209.01	7,334.99	15,449.93	0.00	9,094.07	62.95
11 PAGA DHE SHTESA	21,544.00	14,209.01	7,334.99	12,449.93	0.00	9,094.07	57.79
13 MALLRA DHE SHËRBIME	3,000.00	3,000.00	0.00	3,000.00	0.00	0.00	100.00
66480 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI - HANI ELEZIT	439,706.99	420,938.10	18,768.89	44,396.12	23,047.00	371,435.87	10.10
11 PAGA DHE SHTESA	56,276.99	37,508.10	18,768.89	32,783.12	0.00	23,493.87	58.25
13 MALLRA DHE SHËRBIME	14,959.00	14,959.00	0.00	2,173.28	7,132.00	4,825.72	14.53
30 PASURITË JOFINANCIARE	368,471.00	368,471.00	0.00	9,439.72	15,915.00	343,116.28	2.56

73044 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	16,584.00	11,600.04	4,983.96	9,775.02	0.00	6,808.98	58.94
11 PAGA DHE SHTESA	16,084.00	11,100.04	4,983.96	9,775.02	0.00	6,308.98	60.77
13 MALLRA DHE SHËRBIME	500.00	500.00	0.00	0.00	0.00	500.00	0.00
75050 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - HANI I ELEZIT	366,451.05	257,311.14	109,139.91	151,200.68	21,447.15	192,606.22	41.26
11 PAGA DHE SHTESA	251,951.05	142,811.14	109,139.91	123,987.68	0.00	127,963.37	49.21
13 MALLRA DHE SHËRBIME	70,000.00	70,000.00	0.00	21,447.85	21,237.85	26,117.30	30.64
14 SHPENZIME KOMUNALE	14,500.00	14,500.00	0.00	5,765.15	209.30	8,525.55	39.76
30 PASURITË JOFINANCIARE	30,000.00	30,000.00	0.00	0.00	0.00	30,000.00	0.00
75671 SHËRBIMET SOCIALE - HANI ELEZIT	23,527.99	15,673.10	7,854.89	11,972.88	375.52	11,179.59	50.89
11 PAGA DHE SHTESA	19,727.99	11,873.10	7,854.89	10,937.35	0.00	8,790.64	55.44
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,800.00	2,800.00	0.00	756.16	266.04	1,777.80	27.01
14 SHPENZIME KOMUNALE	1,000.00	1,000.00	0.00	279.37	109.48	611.15	27.94
92175 ADMINISTRATA - HANI I ELEZIT	99,900.67	89,422.58	10,478.09	45,877.02	16,995.00	37,028.65	45.92
11 PAGA DHE SHTESA	32,900.67	22,422.58	10,478.09	19,669.63	0.00	13,231.04	59.78
13 MALLRA DHE SHËRBIME	52,000.00	52,000.00	0.00	26,207.39	1,995.00	23,797.61	50.40
30 PASURITË JOFINANCIARE	15,000.00	15,000.00	0.00	0.00	15,000.00	0.00	0.00
92890 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET - HANI I ELEZIT	76,582.99	53,873.73	22,709.26	42,507.48	619.81	33,306.20	55.51
11 PAGA DHE SHTESA	63,332.99	40,623.73	22,709.26	37,583.32	0.00	25,749.67	59.34
13 MALLRA DHE SHËRBIME	10,250.00	10,250.00	0.00	4,128.72	619.81	5,501.47	40.28
14 SHPENZIME KOMUNALE	3,000.00	3,000.00	0.00	795.44	0.00	2,055.06	26.51
94020 ARSIMI FILLOR - HANI ELEZIT	901,612.00	662,719.31	238,892.69	436,068.40	2,545.96	459,922.09	48.37
11 PAGA DHE SHTESA	695,699.00	456,806.31	238,892.69	407,436.52	0.00	288,262.48	58.57
13 MALLRA DHE SHËRBIME	78,413.00	78,413.00	0.00	24,709.58	2,545.96	48,081.91	31.51
14 SHPENZIME KOMUNALE	14,500.00	14,500.00	0.00	3,922.30	0.00	10,577.70	27.05
30 PASURITË JOFINANCIARE	113,000.00	113,000.00	0.00	0.00	0.00	113,000.00	0.00
95220 ARSIMI I MESËM - HANI I ELEZIT	169,457.99	93,812.57	75,645.42	74,323.92	434.80	94,699.27	43.86
11 PAGA DHE SHTESA	158,079.99	82,434.57	75,645.42	72,478.44	0.00	85,601.55	45.85
13 MALLRA DHE SHËRBIME	7,878.00	7,878.00	0.00	901.27	182.00	6,794.73	11.44
